

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kriza - Shtrenjtimi i tarifave
ADRESA	https://www.syri.net/sociale/916963/shtrenjtimi-i-tarifave-zbraz-bankat-e-shkollave-private-ku-po-shkojne-nxenesit/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHË


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 08:03:45 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 07:55:54 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	034d793fb302b3c64f2e687399702807b75bb88a4a34acd00a87f536bd59a259
TEKSTI	1a269d2361515cd5d7abb66e13f9b1e068bb6afe035ef11b490cd1f1db822e51
PAMJA	45a1042452a9c889dbdab1168109e76299a0461d2fa1cae4e623c67ac2d3a66d

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	2315ceba01b3596a1f1558a44f5305991157dca42ad7b2aed875e6de2dff4581
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	9a66b9440a0861df2d438551387cc4c0076e19988df5fe9b1c9268bd2c93d904
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/2315ceba01b3596a1f1558a44f5305991157dca42ad7b2aed875e6de2dff4581>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



NDRIÇIM KULLA
Gjuha si brushë dhe ironia si armë e Edi Ramës



IRENA BEQIRAJ
Fashizmi nuk duhet kërkuar tek revolta e protestuesve por në Kuvend!



më të lexuarat

Protestë kundër bllokimit të rrugës 200-vjeçare/ Banorët: Duan t'na marrin jetën!
Kalaja: Fushë-Kruja ndahet përgjysmë

Horoskopi, 13 shtator/ Zbulo çfarë parashikojnë yjet për secilën shenjë

Parashikimin e motit për sot -
Temperaturat ulen deri në 29 gradë

Shqipëria po përballet me çmime ushqimore më të shtrenjta se mesatarja europiane! TVSH-ja, ndër më të lartat në BE

'Viti i ri shkollor nis në një mjedis të polarizuar social'/ Sindikata e Arsimit: Politikat arsimore, të pa mjaftueshme

SYRI TV/ Ish-të përndjekurit vonesa me shpërblimet, Zenel Drangu: Një këst zvarritet 5 vjet



Shtrenjtimi i tarifave 'zbraz' bankat e shkollave private, ku po shkojnë nxënësit

09:55, 16/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



Viti i ri shkollor ka nisur me rritje shpenzimesh për familjet që kanë zgjedhur arsimin privat.

Disa shkolla private, në nisje të fillimit të vitit të ri shkollor, shtrenjtuan tarifat e shkollimit nga 15 deri në 20%. Rritja e tarifës u aplikua për të treja ciklet e studimeve, të ulët, 9-vjeçar dhe të mesëm. Shkak i shtrenjtimit është njoftuar rritja e pagës së mësuesve dhe tarifës të transportit prej shtrenjtimit të naftës.

Por pasojat e shtrenjtimit nuk janë ndërjet vetëm për buxhetin e familjarëve. Në disa shkolla private, rritja e tarifave ka sjellë edhe largimin e një numri të konsiderueshëm nxënësish, drejt shkollave publike.

Mësuesit pohojnë se bazuar edhe në sondazhet e kryera me prindërit, arsyeja kryesore e largimeve është pikërisht rritja e kostonë së shkollimit.

Në shkollat private totali i tarifës përbëhet nga 3 zëra, tarifa e studimit, ushqimit dhe transportit.

Për shembull në një nga shkollat private tarifa totale mujore që paguante një prind për një fëmijë të ciklit të ulët ishte 15 mijë lekë studimi, 5 mijë lekë transporti dhe 6 mijë lekë ushqimi. Në total 26 mijë lekë në muaj.

Pas rritjes tarifa mujore e studimit arriti 19 mijë lekë, transporti 6 mijë lekë dhe tarifa e ushqimit 7 mijë lekë. Në total tarifa arriti 31 mijë lekë në muaj. Rritja është 5 mijë lekë apo 19 % në muaj.

Për një familje me 2 fëmijë, me rritjen e tarifave kostoja e shkollimit bëhet e papërbalueshme.

Kjo ka sjellë që për disa shkolla private largimi i nxënësve të arrijë në numër nga 3 deri në 7 nxënës në klasë. Në shkollat private numri i nxënësve varion nga 15 deri 20 nxënës për klasë. Në një klasë me 20 nxënës 7 të larguar zënë gati 35% të larguarve.

Edhe në një shkollë private të ciklit të ulët prindërit pohojnë se rritja e tarifës

vjetore 500 euro apo 15% më shtrenjtë ndikoi te vendimi për largimin e fëmijës në një shkollë publike.

Një tjetër element është zgjerimi i shërbimit "pas shkolle" në arsimin shtetëror, i cili u mundëson prindërve që fëmijët të qëndrojnë më gjatë në ambientet e shkollës, edhe pas përfundimit të orarit mësimor. Ky është ende një projekt pilot, që zbatohet në disa klasa.

Ky shërbim përfshin edhe kohën e studimit dhe është kthyer në një nga avantazhet që kanë pasur shkollat private, duke bërë që shumë prindër t'i zgjedhin ato për shkak të orareve më të gjata.

Megjithatë, programi publik ende nuk përfshin ofrimin e vaktit të drekës, një shërbim që do të kishte një kosto të konsiderueshme për buxhetin.

Nga Ministria e Arsimit llogarit se nëse programi do të zbatohet për të gjithë sistemin 9-vjeçar në vend (nga klasat e para deri në klasat e 9) kostoja vjetore arrin rreth 203 mln euro në vit./**MONITOR**

© SYRI.net

Lexo edhe:



Aktivistët: Ligji i ri për personat me aftësi të kufizuara do të mbetet një tjetër premtim në letër



Njihuni me parashikimin e motit për sot dhe temperaturat për çdo qytet



Si të hiqni në mënyrë efektive gërvishtjet nga sipërfaqet e qelqit: Proveni këto truke të thjeshta

SYRI TV/ Fier, fshatrat e Bishanit drejt braktisjes, shkollat e mbyllura mbulohen nga ferrat

SYRI TV/ Elbasan, mbetjet urbane ngecin në urë, përroi i Zaranikës shqetësim për banorët

Blokohet lëndë drusore e prerë në mënyrë të paligjshme në Kolesjan

TË NGJASHME



SYRI TV/ Elbasan, mbetjet urbane ngecin në urë, përroi i Zaranikës shqetësim për banorët



SYRI TV/ Fier, fshatrat e Bishanit drejt braktisjes, shkollat e mbyllura mbulohen nga ferrat



SYRI TV/ Ish-të përndjekurit vonesa me shpërblimet, Zenel Drangu: Një këst zvarritet 5 vjet



Pasojat në punë, beqarët e dashuria - Kujdes me financat sepse yjet tregohen të rezervuar



Kthjellime dhe vranësira mesatare - Ja si do të jetë moti këtë 15 shtator



SYRI TV/ Neviçishti pa nxënës, shkolla mbyll dyert, në fshat kanë mbetur vetëm të moshuar



SYRI TV/ Të pamundur për të blerë mjetet mësimore, fëmijët e familjes Dopi rrezikuan shkollën

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË-STIL TRASHËGIMI MIEDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojme të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Staf i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net